

VENDIM
Nr. 111, datë 14.5.2018

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË OSHEE SHA,
PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË KA NËNSHKRUAR KJO SHOQËRI
ME SHOQËRINË E LICENCUAR NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME ENERGJI
ELEKTRIKE “GRID ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe të nenit 20.1 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.5.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a. për miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar kjo shoqëri me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike “Grid Energy” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 7748 prot., datë 27.4.2018, ka dërguar në ERE marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nr. 6730 prot., datë 13.4.2018 dhe nr. 8 prot., datë 13.4.2018, nënshkruar midis OSHEE sh.a. dhe “Grid Energy” sh.p.k., me qëllim miratimin nga ERE.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 96, datë 27.10.2014, ka vendosur për licencimin e shoqërisë OSHEE sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 48, datë 31.3.2017, është shprehur mbi licencimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 15.2.2017, ka miratuar “Marrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike”.

- Në nenin 20.1 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike” sanksionohet se: Kjo marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën palë dhe 1 për t’u dërguar për miratim në ERE”.

- Në përmbajtjen e saj, kjo marrëveshje e nënshkruar dhe e dakordësuar mes palëve ka reflektuar saktësisht të gjitha dispozitat që ERE ka parashikuar në marrëveshjen tip të cilën e ka miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë e kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nr. 6730 prot., datë 13.4.2018 dhe nr. 08 prot., datë 13.4.2018, nënshkruar midis OSHEE sh.a. dhe “Grid Energy” sh.p.k.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti